

Data 28.10.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim i pastrimit për zyrat dhe Qëndrat e Kujdesit Ndaj Klientit të OSHEE Group sh.a”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT- - 90919200-4 -
Shërbime pastrimi zyre.

VLERA E FONDIT LIMIT: 24,725,228 (njëzet e katër milion e shtatëqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e njëzet e tetë) All, pa TVSH,
ose

- 254,899.2 (dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë nëntë pikë dy) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 27.10.2025, 1 euro = 97 All.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

Ne zbatim te Paragrafit 2, Pika 1, e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, Objekti i kontrates lidhet me sherbimin e pastrimit te cilin e perfiton shoqeria OSHEE GROUP SHA, OSSH SHA dhe FSHU SHA, dhe ne menyre te detajuar baza materiale per ofrimin e ketij sherbimi do te menaxhohet nga DSHM e cila do te shperndahet sipas nevojave te drejtorive/sektoreve/zyrave perkatese. Persa me lart ndarja ne lote do ta nderlikonte dhe veshtiresonte procesin e zbatimit te kontrates duke krijuar vonesa dhe rrjedhimisht do sillte veshtiresi per stafin kerkues te bazes materiale. Per shkak te organizimit dhe marredhenieve qe ruajne te kater shoqerite me njera tjetren, kjo kontrate nuk mund te ndahet ne lote pasi ne thelb te gjithe artikujt objekt i kontrates i perkasin te njejtës kategori produktesh.

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 33, të ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna/Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Rregjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rendesinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën **jo më pak se vlera e fondit limit**.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nën 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij nëni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislationit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislationit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislationit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë afersisht sa 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijojnë kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatorëve ekonomik që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavarësisht rendesise dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymen e konkurueshmërisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 35 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë licencën e mëposhtme:

- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore (dezinfektim).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Vendim Nr. 538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendres Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nenligjore të përbashkëta”, si dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcakton Ligji 10431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (të ndryshuar), . Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”,

Shërbimet e dezinfektimit janë të rëndësishme për sigurinë dhe shëndetin publik. Përmasat e pandemisë së COVID-19 dhe nevoja për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve të tjera kanë bërë të qartë se dezinfektimi është një pjesë e rëndësishme e pastërtisë dhe sigurisë së ambienteve publike. Licencat e lëshuara nga Qendra Kombëtare e Licensimit, sigurojnë se operatorët janë të kualifikuar për të kryer këtë detyrë me kujdes dhe profesionalizëm. Për të kryer dezinfektimin me efikasitet, është e rëndësishme që operatori ekonomik ofertues të ketë njohuri dhe trajnime profesionale në lidhje me metodat dhe substancat e përdorura për dezinfektimin. Një licensë nga një autoritet i licensimit e bën operatorin ekonomik ofertues përgjegjës para ligjit për veprimtarinë e tij. Kjo siguron se operatori do të respektojë standardet dhe udhëzimet e ofruara nga autoriteti i licensimit dhe do të përballojë çdo shkelje të këtyre standardeve në mënyrë të rregullt.

Kriteret per licensat e leshuar nga QKL jane vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje zoteron kapacitetet teknike per realizimin me sukses te kontrates.

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimit, ku të përfshihen ndër të tjera edhe marrja e masave për ndikim në mjedis.

2.3.3 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 42 (dyzet e dy) persona të punësuar, te cilet duhet te jene te listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik per për muajin e fundit (*duke marre si reference data e hapjes se ofertave*), në profilet sipas tabelës se mëposhtme:

Stafi	Nr.
Drejtues Teknik	1 (një)
Punonjes sherbimi/Sanitar	30(tridhjetë)
Punonjes i specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë	1 (nje)
Specialist të kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun dhe menaxhimin e agjentëve kimikë	1 (nje)
Shofer per transport materialesh	4 (kater)
Punonjes dezinfektimi	4(kater)
Shofer per platformen levizese	1 (nje)
Totali i punonjësve	42 (dyzet e dy)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

➤ **Për Drejtuesin Teknik OE duhet te paraqese:**

- Diplomë
- Kontrate pune perkatese.

Për të vërtetuar disponimin e stafit te mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, (*duke marre si reference data e hapjes se ofertave*) dhe Vertetim nga Dega e Tatim Taksa ose Dega e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore, qe ka paguar te gjitha detyrimet e sigurimeve shoqerore, te leshuar nga Administrata Tatimore, ku te pasqyrohet numri i punonjesve për muajin e fundit, (*duke marre si reference data e hapjes se ofertave*).
- **Per punonjësit punonjes sherbimi/Sanitare**,te paraqitet vetem kontrate pune perkatese ,nga keta te pakten 3 punonjes per punime ne lartesi te pajisur me certifikata trajnimi per punime ne lartesi (per shkak te pastrimit te fasadave ne lartesi) per ndjekien/zbatimin e kontrates.

- **Për punonjesin e specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë** sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” duhet te paraqese:

- kontrate e pune perkatese dhe certifikate

- **Per specialistin e kualifikuar** sipas formimit profesional për rrezikun dhe menaxhimin e agjentëve kimikë – minimalisht 1(një), sipas Udhezimit te perbashket APP dhe MSHMS nr 294 date 06.05.2020 (ose ne perputhje me cdo ndryshim qe mund te pesoje ky udhezim pergjate zbatimit te kontrates) duhet te paraqese:

- kontrate e punes perkatese dhe certifikate

- **Per punonjesit shofere transporti** duhet te paraqese;

- kontraten e punes perkatese dhe leje drejtimi

- **Per punonjesit e dezinfektimit** duhet te paraqese;

- kontraten e punes perkatese

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatës të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic eshte sherbim pastrimi, stafi i kerkuar eshte nje numer minimal duke u bazuar ne nevojen e kryerjes se sherbimit.

Duke pasur parasysh se objekti i kontrates perfshin edhe shperdarjen e materialeve sipas pikave te percaktuara ne termat e references, eshte perlllogaritur edhe personeli i nevojshem per realizimin e ketij detyrimi. Perlllogaritja eshte bazuar ne ndarjen rajonale te Drejtorive dhe te KNK-ve.

Per Drejtuesin Teknik: Kërkesa mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*" Neni 7 Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. *Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurse e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institucion*, Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "*Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune*", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te realizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi. Garantimi i ekspertizes së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e diplomës dhe kontratës së punës perkatese tregon se Drejtuesi Teknik është i kualifikuar për detyrën dhe ka njohuritë e duhura për të menaxhuar dhe udhëhequr operacionet e pastrimit dhe dezinfektimit me efikasitet. Kjo siguron që shërbimi do të ketë një drejtim profesional dhe të përshtatshëm.

Deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e-Albania tregon se Drejtuesi Teknik është i ligjshëm dhe i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për të kryer detyrën. Deklarata nga administratori i shoqërisë që konfirmon se drejtuesi teknik nuk është i angazhuar në kontrata të tjera siguron që Drejtuesi Teknik do të jetë i përqendruar në detyrat e tij për operatorin ekonomik dhe nuk do të ketë konflikt të interesave. Kërkesa për paraqitjen e këtyre dokumenteve është një mënyrë për të bërë shërbimin më transparent dhe për të garantuar se operatori ekonomik është i pajisur me drejtuesin e duhur me aftësitë dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Për punonjesin e specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë: Ky person i licensuar kërkohet dhe cmohet i nevojshëm prania e tij gjatë zbatimit të kontratës me qellim mbrojtjen e shëndetit fizik dhe mendor dhe të sigurisë së punëmarrësve, si dhe në përmirësimin e kushteve të punës.

Punonjësi i specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë ka një rol kritik në garantimin e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve. Përmes kontratës së punës perkatese, kjo person siguron që ligjshmëria dhe kërkesat e sigurisë në punë janë të përmbushura dhe zbatohen në mënyrë të efektshme.

Per specialistin e kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun dhe menaxhimin e agjentëve kimikë: Ky person i licensuar kërkohet dhe cmohet i nevojshëm prania e tij gjatë zbatimit të kontratës për shkak të shmangjes së rrezikut nga agjentët kimik lidhur me solucionet që do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit të dezinfektimit nga ana e operatorit ekonomik.

Për të menaxhuar me efikasitet agjentët kimikë dhe minimizuar rreziqet e ndotjes kimike, është e rëndësishme të ketë një specialist të trajnuar. Këto agjentë kimikë janë të rrezikshëm dhe kërkojnë një kuptim të thellë të menaxhimit të tyre dhe sigurisë së mjedisit. Një specialist i kualifikuar është i aftë të identifikojë rreziqet dhe të zhvillojë protokolle për t'i menaxhuar ato në mënyrë të sigurt. Udhezimi i përbashkët i APP dhe MSHMS është një dokument zyrtar që përcakton kërkesat dhe praktikatat e rekomanduara për menaxhimin e agjentëve kimikë. Paraqitja e një specialisti të kualifikuar tregon për përmbushjen e këtyre kërkesave dhe ligjshmërinë në menaxhimin e agjentëve kimikë.

Per punonjësit shofere transporti: Kerkohen 4 shofere per transportin e materialeve te nevojshem per kryerjen e sherbimit duke pasur parasysh shperndarjen gjeografike.

Duke qene se per kryerjen e sherbimit kerkohet nje platformë lëvizëse për ngritjen e njerëzve, për punimet në lartesi është i nevojshëm dhe shoferi për platformën levizëse.

1. **Per punonjësit dezinfektimi:** Kerkohen 4 punonjes. Punonjësit e dezinfektimit janë të trajnuar dhe të specializuar për të kryer procedurat e dezinfektimit me sukses. Ata kanë njohuri të thellë në lidhje me agjentët dezinfektues, metodat e aplikimit dhe standardet e sigurisë së punës. Kriteri për punonjësit e dezinfektimit siguron që operatori ekonomik ka personelin e duhur me kompetenca të specializuara për të menaxhuar efikasitetin dhe sigurinë e dezinfektimit Punonjësit e dezinfektimit duhet të operojnë në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e duhura të dezinfektimit. Kriteri për punonjësit e dezinfektimit siguron përmbushjen e kërkesave të ligjshmërisë dhe të rregullave për të garantuar që puna është e kryer në mënyrë të ligjshme dhe profesionale.

2. **Per punonjësit punonjes sherbimi/Sanitare,** te paraqitet :

- kontrate pune perkatese,dhe nga keta te pakten 3 punonjes te pajisur me certifikata trajnimi per punime ne lartesi (per shkak te pastrimit te fasadave ne lartesi).

Sqarojmë se nga ana e autoritetit kontraktor janë kërkuar 30 punonjës shërbimi sanitar, pasi referuar dhe Specifikimeve Teknike të ngarkuara në sistemin e prokurimeve elektronike në dosjen e tenderit është parashikuar se vetëm për zyrat e administratës Qendrore FSHU dhe OSSH do të

duhen 7 punonjës të dedikuar dhe për zyrat e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë do të ketë 2 punonjës të dedikuar me kohë të plotë (pra gjithsej 9 punonjes) ndërsa duke marrë në konsideratë të gjitha pikat e OSSH dhe FSHU ku ushtrohet aktiviteti sipas listës bashkëlidhur dhe sipërfaqeve që kërkohen të pastrohen sqarojmë se numri i punonjësve është me I madh se diferenca e mbetur (30-9) duke marrë në konsideratë sipërfaqet dhe distantat midis insitucioneve dhe për rrjedhojë autoritetit kontraktor është mjaftuar vetëm me minimumin që duhet të disponojë një operator ekonomik pasi në të vërtetë ky numër duhet të jetë më I madh por për të mos krijuar pengesa artificiale dhe për të bërë të mundur dhe stimulimin e biznesit të vogël për të marrë pjesë është vendosur ky numër. Sqarojmë se autoriteti kontraktor referuar dhe dispozitave ligjore përkatëse nuk ka asnjë të drejtë të vendosi kriteret kualifikuese tej atyre të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës ndërsa për minimumin e tyre është lënë në diskrecion të organit public. Në hartimin e kriterëve autoritet kontraktore ka shmangur çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt sic është rasti konkret dhe që mund të passillin uljen e konkurrencës

Autoriteti Kontraktor në Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim sqaron se janë hartuar në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

Në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Në rastin konkret kërkimi për disponimin e 30 punonjësve shërbimi është i bazuar ligjërisht, si dhe është në proporcion dhe në përputhje me objektin e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare:

- 1) ISO 9001 ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- 2) ISO 45001:2018 (Standard Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë)/ekuivalente dhe e vlefshme.
- 3) ISO 14001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të cilësisë të mjedisit (e vlefshme);.

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Certifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Gjithashtu, këto certifikata janë të nevojshme për të vërtetuar që operatori ekonomik ofertues ushtron aktivitet në pajtueshmëri me standardet e kërkuara të cilësisë dhe të menaxhimit të Sigurisë / menaxhimit të shërbimit i ofruar dhe do të realizohet sipas standarteve ndërkombëtare ISO.

Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., datë 09.04.2021, si dhe Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Standardi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001 ose 18001 është vendosur si kriter kualifikues për operatorët ekonomik ofertues sepse ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila është me një rëndësi të vecantë për kryerjen e këtij shërbimi. Gjithashtu domosdoshmëria e kësaj ISO-je si kriter kualifikues, konsiderohet me e rëndësishme kur OE përdor makineri të tilla si platforme ajrore ngritëse dhe makineri e pajisje të tjera profesionale.

Standardi i menaxhimit të cilësisë së mjedisit ISO 14001 është kërkuar nga AK pasi garanton se OE ofertues do të sjellë produktet të cilat nuk demtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë, që janë konform standardeve ndërkombëtare të cilësisë në këtë orientim.

Standardi i cilësisë ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

2.3.5 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

1. Makineri thithese pluhurash dhe lengjesh - minimumi 10 cope
2. Makineri larje-tharje- minimumi 3 cope
3. Fshesa korenti - minimumi 10 cope
4. Paisje për larjen e dritareve me gjatësi mbi 10 metra- 1 cope

Per te provuar disponimin e makinerive profesionale me parametrat e kerkuar, operatori ekonomik duhet te paraqese kataloge / skede teknike per makinerite profesionale, ku te pasqyrohen te dhenat e kerkuara me siper.

Për makineritë me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore /zhdoganim/kontrate blerje).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme lidhet me parashikimet e termave te references dhe kerkesave per realizimin e sherbimit. Keto pajisje/makineri te kerkuara sherbejne per realizimin e proceseve te punes te parashikuara ne terma reference si dhe duke qene se sherbimi do te ofrohet ne gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise ne rreth 161 objekte eshte vleresuar te kerkohet nje numer minimal makinerish/pajisjesh qe deshmojne se operatori ka kapacitetin per realizimin e sherbimit*

Makineri thithese pluhurash dhe lengjesh

Pajisja eshte projektuar per te pastruar ne siperfaqe te thate dhe te lagesht, duke e bere te pershtatshme per pastrime ne mjedise te ndryshme, duke mare parasysh dhe fuqine, pajisja heq ne menyre efektive pluhurin, papastertite, derdhjet e lengjeve etj. Makineria e thithjes se pluhurave ne te thate dhe te lagesht mund te perdoret ne menyre shume komode si ne ambjentet e brendshme dhe te jashtme, duke mare ne konsiderate dhe ambjentet e Autoritetit ku jane te brendshme dhe ballkone ose obore te jashtme, gjithashtu dhe numrin prej 161 ambjente, arsyetojme se minimalisht per te plotesuar nevojat duhen 10 cope. Makineria thithëse e pluhurash dhe lëngjesh është kritike për të larguar dhe kontrolluar substancat e ndryshme të ndotura. Paraqitja e mjetëve të nevojshëm tregon se operatori ekonomik është i pajisur për të ofruar shërbimin me efikasitet dhe cilësi të lartë.

Makineri larje-tharje- minimumi 3 cope: Makineria e larjes dhe tharjes është e projektuar për të siguruar që puna e pastrimit dhe larjes të kryhet me siguri dhe në përputhje me standarde të

higjienës. Paraqitja e këtyre mjetëve siguron që operatori ekonomik ka kujdes për sigurinë dhe higjienën në vendin e punës dhe në ambientet e drejtorive.

Fshesa korenti - minimumi 10 cope Fshesat e korentit janë pajisje të rëndësishme për të pastruar dhe tharë sipërfaqet e ujit dhe të lagur, të cilat janë të përdorura në ambiente të shumta, përfshirë drejtoritë. Për të përmbushur kontratën me sukses dhe për të siguruar një pastrim të përshtatshëm të këtyre ambienteve, është e nevojshme të keni në dispozicion fshesa korenti në numër të mjaftueshëm.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se disponon *Mjete transporti per punonjesit dhe mallrat – minimalisht 4 (kater) cope*

Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqitet dokumentacioni I tij (leje qarkullimi, kolaudim, sigurim i detyruar TPL, foto.)

Argumentimi per piken 2.3.6 dhe 2.3.7: Kërkesat e mësipërme lidhen me parashikimet e termave te references dhe kerkesave per realizimin e sherbimit, konkretisht per realizimin ne menyre te duhur dhe te sigurt te pastrimit ne lartesi. Kerkohen 4 mjete per transportin e materialeve te nevojshem per kryerjen e sherbimit duke pasur parasysh shperndarjen gjeografike.

Duke qene se ne ambientet qe do te kryhet sherbimi ka vetrata dhe xhama ne lartesi te medha kerkohet edhe nje platforme ne menyre qe te realizohet pastrimi I tyre.

Në punët në lartësi, siguria është e kritike. Disponimi i një platforme levizëse e cila është e palëvizshme siguron që njerëzit mund të punojnë në lartësi në mënyrë të sigurt dhe të stabilizuar. Platforma e cila nuk lëviz ndihmon në parandalimin e aksidenteve dhe rreziqeve të lëvizjes së paplanifikuar. Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se platforma e tyre është e përshtatshme për këtë qëllim dhe ka mekanizma të sigurisë të mjaftueshëm për të parandaluar aksidentet. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë prova se platforma e tyre është e përshtatshme për punën specifike që do të kryhet. Kjo përfshin karakteristikat teknike të platformës, si kapaciteti i ngarkesës, lartësia maksimale që mund të arrihet dhe të tjerat. Kjo siguron që puna do të kryhet me efikasitet dhe pa problem.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se disponon platformë levizëse për ngritjen e njerëzve, për punimet në lartësi.

Për vërtetimin e këtij kriteri duhet të paraqitet dokumentacioni i tij (leje qarkullimi, kolaudim, sigurim i detyruar TPL, foto. se bashku me specifikimet teknike te krahut **ku te tregohet lartesia mbi 15 metra**)

Per mjetet me qira duhet te paraqitet kontrata e qirase e lidhur para noterit, me afat per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt prokurimi, e shoqeruar me dokumentacion qe verteton pronesine e qiradhenesit (leje qarkullim, kolaudim, leje transporti, sigurim i detyruar TPL foto dhe raporti i inspektimit te konformitetit) se bashku me specifikimet teknike te krahut (te perkthyer dhe te noterizuara) **ku te tregohet lartesia mbi 15 metra.**

2.3.8 Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me Licence DDD te vlefshme, (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim).

Gjithashtu ne kete kuader Operatori ekonomik duhet te provoje disponimin e minimumi **10 pompa dezinfektimi (Pompa profesionale per sperkatjen e dezinfektantit, 5 pompa ULV, dhe 1** pajisje mjegulluese që të operojë me parimin e injektimit të lëngshëm në gazrat e nxehta.

Për vërtetimin e disponimit te ketyre pajisjeve, operatori ekonomik mund ti disponoje ne pronesi ose me qira, ne varesi te menyres se disponimit duhet të paraqesë faturat e blerjes/zhdoganimit/kontrata qeraje së bashku me specifikimet teknike të pajisjes .

Termat e shërbimit do te jene sipas percaktimeve te Udhezimit te perbashket te APP dhe MSHMS nr. 294, date 06.05.2020.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë licensen dhe pajisjet e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Licence DDD te vlefshme kerkohet pasi ne termat e references eshte parashikuar te ofrohet edhe shërbimi i Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim. Gjithashtu te gjitha pajisjet e kerkuara me lart lidhen ngushtesisht me proceset e punes se shërbimit DDD te kerkuar ne termat e references.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termat e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per shërbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare

dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.